

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*” është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Institucioni propozues i këtij projektligji është Ministria e Financave.

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor tatimor nëpërmjet ndërhyrjeve që modernizojnë procedurat, rrisin efikasitetin e administratës tatimore dhe lehtësojnë përmbushjen e detyrimeve nga tatimpaguesit.

Konkretisht, ndryshimet konsistojnë në:

- Rritjen e përdorimit të komunikimit elektronik dhe uljen e shërbimeve postare si një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të administratës tatimore dhe përmirësimit të efikasitetit në komunikimin me tatimpaguesit. Kjo qasje synon të reduktojë kostot operacionale, të përshpejtojë proceset e njoftimit dhe të rrisë transparencën, duke e bërë më të lehtë dhe më të shpejtë shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve. Përdorimi i kanaleve elektronike gjithashtu ndihmon në garantimin e gjurmueshmërisë dhe sigurisë së komunikimeve, duke ulur varësinë nga shërbimet tradicionale postare, të cilat shpesh janë të ngadalta dhe më pak të sigurta.
- Saktësimin në ligj se edhe veprimtaria e ushtruar nëpërmjet internetit përbën veprimtari ekonomik-tregtare dhe, si e tillë, i nënshtrohet detyrimit për regjistrim dhe tatim. Ky përcaktim synon të shmangë çdo keqinterpretim apo pretendim për mungesë detyrimi nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në formë elektronike, pavarësisht vendit, mënyrës apo mjetit të ushtrimit të saj.

Në kuadër të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në raportin për *“Blerjet online në Shqipëri taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit”*, është propozuar detyrimi për publikimin e të dhënave identifikuese në faqet e internetit ku ushtrohet kjo veprimtari. Kjo masë parandalon shmangien e detyrimeve fiskale dhe krijon një mjedis më të drejtë dhe konkurrues për të gjithë aktorët ekonomikë. Për më tepër, parashikimi i mundësisë së pezullimit të faqes së internetit në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi siguron zbatimin efektiv të normave ligjore dhe mbështet luftën kundër informalitetit në tregun online.

- Zgjerimin e bazës ligjore për aplikimin e masave administrative ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari tregtare pa qenë të regjistruar. Ndryshimi saktëson se përveç gjobës së parashikuar në nenin 121, mund të aplikohen edhe masa të tjera administrative të parashikuara në legjislacionin tatimor. Kjo ndërhyrje synon të rrisë efektivitetin e administratës tatimore në luftën kundër informalitetit dhe të garantojë trajtim të barabartë për të gjitha subjektet që shkelin detyrimet ligjore, duke kufizuar hapësirat për abuzim apo shmangie nga përgjegjësia tatimore.
- Zvogëlimin e përdorimit të parasë në dorë në transaksionet ndërmjet bizneseve, duke ulur kufirin e lejuar për pagesat me para në dorë nga 150 000 lekë në 100 000 lekë. Kjo masë synon të rrisë transparencën dhe gjurmueshmërinë e transaksioneve, si dhe të reduktojë evazionin fiskal, duke nxitur përdorimin e pagesave përmes sistemit bankar, të cilat janë më të lehta për t’u kontrolluar dhe verifikuar nga administrata tatimore.
- Vendosjen e një kufiri për transaksionet me para në dorë që personat fizikë, individët e vetëpunësuar dhe tregtarë, apo entitetet kryejnë me individë, kur vlera e transaksionit kalon pragun e 500 000 lekë. Kjo ndërhyrje synon të forcojë kontrollin mbi qarkullimin e parasë jashtë sistemit financiar formal dhe të rrisë nivelin e formalizimit të transaksioneve.
- Në kuadër të politikave për reduktimin e përdorimit të parasë në dorë dhe nxitjen e pagesave elektronike, propozohet gjithashtu vendosja e detyrimit për pajisjen me terminal “POS” në pikat e shitjes të tatimpaguesve që kryejnë veprimtari ekonomike me pagesa me para në dorë sipas afateve të parashikuara në ligj. Ky ndryshim synon të rrisë transparencën fiskale, të

lehtësojë gjurmueshmërinë e transaksioneve, si dhe të forcojë procesin e formalizimit të ekonomisë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve moderne të pagesës.

- Përfshirjen nga kamatëvonesat për institucionet publike, në rastet kur mosrespektimi i afateve të deklarimit apo pagesës së detyrimeve vjen si rezultat i zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese ose vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ky përfshirje synon të mbrojë institucionet publike nga penaltete që burojnë nga faktorë objektivë dhe të pavarur nga vullneti i tyre.
- Vendosja e sanksioneve administrative ndaj prodhuesve ose mirëmbajtësve të softëare-it të pajisjeve fiskale në rastet e refuzimit të bashkëpunimit me administratën tatimore me qëllim bashkëpunim të plotë të prodhuesve dhe mirëmbajtësve të softëare-it të pajisjeve fiskale me administratën tatimore, në rastet kur kërkohet hapja ose verifikimi i pajisjeve fiskale të konfiskuara. Me këtë ndryshim vendoset detyrimi ligjor për bashkëpunim dhe parashikohen sanksione administrative në rastet e refuzimit, me synim forcimin e kontrollit dhe garantimin e funksionimit të rregullt të sistemit të fiskalizimit.
- U jepet e drejta tatimpaguesve individë të korrigjojnë deklaratën vjetore të të ardhurave personale brenda 6 muajve nga data e dorëzimit, me mundësinë për të kryer jo më shumë se dy korrigjime, si dhe parashikohet reduktimi i afatit për dorëzimin e deklaratave të ndryshuara nga 36 muaj në 24 muaj. Qëllimi i këtij ndryshimi është të përmirësojë procesin e vetëdeklarimit dhe korrigjimit të deklaratave tatimore nga individët, duke krijuar një mekanizëm më efikas, të saktë dhe të përcaktuar qartë në kohë.
- Rregullimin e disa referencave ligjore në përputhje me ligjin e ri nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor tatimor dhe forcimit të zbatimit të tij, ky projektligj parashikon adresimin e disa çështjeve thelbësore lidhur me luftën kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së transaksioneve ekonomike, si dhe sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare. Në këtë kuadër, argumentet për ndryshimet ligjore të propozuara konsistojnë si vijon:

1. Saktësimi i veprimtarisë elektronike si veprimtari ekonomiko-tregtare dhe detyrimi për transparencë

Në kushtet e zhvillimit të shpejtë të ekonomisë digjitale, është e nevojshme të përcaktohet qartë se veprimtaria e ushtruar nëpërmjet internetit përbën veprimtari ekonomiko-tregtare dhe i nënshtrohet detyrimit për regjistrim dhe tatim, duke shmangur çdo keqinterpretim nga subjektet që operojnë elektronikisht dhe duke siguruar trajtim të barabartë për të gjithë.

Në vijim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për rritjen e transparencës dhe luftën kundër informalitetit, në këtë projektligj propozohet gjithashtu detyrimi i publikimit në faqet e internetit të të dhënave identifikuese të subjekteve që ushtrojnë këtë veprimtari (NIPT, emër, adresë, numër telefoni). Kjo masë parandalon shmangien e detyrimeve fiskale dhe krijon një mjedis më të drejtë dhe konkurrues, ndërsa parashikimi i mundësisë së pezullimit të faqes së internetit në rast mosrespektimi siguron zbatimin efektiv të parashikimeve ligjore.

2. Zgjerimi i bazës së penalteteve për subjektet e paregjistruara

Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar në QKB, vendos masën e bllokimit të mallrave dhe detyron personin të regjistrohet menjëherë në QKB, si tatimpagues i tatimit mbi vlerën e shtuar. Masa e bllokimit hiqet pas kryerjes së regjistrimit për veprimtarinë ekonomike, duke aplikuar masat dhe dënimin, sipas pikës 2, të nenit 121, të këtij ligji. Pika 2 e nenit 121 përcakton se vlera e TVSH-së së munguar bëhet duke vlerësuar mallin e gjetur pa faturë me çmimin e tregut.

Ky propozim synon të përcaktojë se pjesë e penaliteteve të tatimpaguesve të paregjistruar do të jenë edhe masat e tjera administrative të parashikuara në ligj për të gjitha shkeljet e konstatuara. Nga zbatimi në praktikë i kësaj dispozite nga strukturat e terrenit të administratës tatimore është konstatuar se, mos aplikimi i të njëjta penaliteteve për personat e paregjistruar për shkeljet e konstatuara gjatë verifikimit në terren si: mos deklarimi i punonjësve; mbajtja e mallrave pa faturë, mos lëshimi i faturës tatimore, etj., të cilat aplikohen për tatimpaguesit e regjistruar, ka sjellë një trajtim më të lehtësuar të tyre dhe krijon jo vetëm pabarazi përpara ligjit, por çënon konkurrencën e ndershme dhe nxit informalitetin. Po ashtu nga ana e administratës tatimore nuk bëhej vlerësimi tatimor i mallrave të gjetur pa faturë, pasi individit konsiderohej i pa regjistruar.

3. Rritja e përdorimit të komunikimit elektronik dhe ulja e shërbimeve postare

Ndryshimet në nenin 23 synojnë që korrespondenca me tatimpaguesin të kalojë në komunikim elektronik, duke përfshirë nënshkrimin elektronik të akteve administrative, nga administrata tatimore. Me këtë ndryshim ligjor synohet që korrespondenca me tatimpaguesin të kalojë në një nivel të ri, duke i dhënë përparësi komunikimit elektronik për aktet administrative të cilat nënshkruhen elektronikisht nga Administrata Tatimore. Heqja e shërbimit postar për njoftimin e akteve për të cilat mund të realizohet nënshkrimi elektronik nga Administrata Tatimore, do të krijonte një sërë lehtësirash, jo vetëm për tatimpaguesin, i cili merr në kohë reale aktet administrative, por edhe për vetë Administratën Tatimore, nëpërmjet lehtësimit të procesit të punës së punonjësve të Administratës Tatimore, apo edhe minimizimit të shpenzimeve në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në zërin e shpenzimeve postare dhe kancelarike.

Gjithashtu, saktësohet se tatimpaguesit i kërkohet që të bëjë deklaram të saktë të adresës ku ushtron veprimtarinë dhe adresës elektronike.

4. Ulja e përdorimit të parasë në dorë

Përdorimi i parasë fizike mbetet ende mbizotërues në ekonominë shqiptare, duke mbartur kosto të larta për aktorët ekonomikë. Për këtë arsye, është thelbësore nxitja e përdorimit të instrumenteve më efikase dhe me kosto të ulëta, që përbën një nga prioritetet e qeverisë për uljen e informalitetit, por edhe të Bankës së Shqipërisë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 847, datë 26.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Plani i Veprimit,

2024-2027” miratoi këtë strategji, e cila ndër të tjera përcaktoi uljen e parasë cash në ekonomi, si një ndër prioritetet në fushën e administrimit fiskal.

Pjesë e masave të caktuara në këto priorite janë: 1) vendosja një limiti për pagesat cash mes individëve dhe 2) reduktimi i mëtejshëm për pagesat me para në dorë mes bizneseve. Gjithashtu, Ministria e Financave është duke punuar me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën e Bankave për të ulur komisionet e përdorimit të terminaleve POS mes bankave të nivelit të dytë dhe tatimpaguesve.

Të dhënat nga administrata tatimore tregojnë metodat kryesore të pagesës së faturave nga bizneset, ku përfshihen banknotat dhe monedhat, kartat bankare, çeket dhe voucher-ët, sipas kategorive të klientëve B2B (biznes me biznes) dhe B2C (biznes me konsumator), si dhe sipas intervaleve të shumave të faturës. Pjesa dërrmuese e qarkullimit vijon të mbizotërohet nga cash-i, ndërkohë që përdorimi i mjeteve elektronike të pagesës është ende i kufizuar. Kjo pasqyron një sfidë për rritjen e formalizimit dhe digjitalizmit të pagesave në ekonomi.

Ndërkohë që, sipas raportit të Statistikave të raportit të pagesave të publikuar në Bankën e Shqipërisë, numri i terminaleve POS ka arritur në rreth 30 mijë njësi në tremujorin e dytë të vitit 2025, krahasuar me rreth 14 mijë gjatë vitit 2021, çka tregon një rritje të ndjeshme të përdorimit të këtyre pajisjeve, megjithatë krahasuar me numrin e bizneseve që është mbi 130 mijë, numri i terminaleve POS vijon të mbetet i vogël. Nxitja e mëtejshme e pajisjes së tatimpaguesve me terminale POS do të lehtësojë kryerjen e transaksioneve elektronike, duke rritur transparencën dhe ulur varësinë nga pagesat me para fizike.

Në SAA janë përcaktuar disa prioritete për uljen e cash në ekonomi, mbi të cilat janë propozuar ndryshimet si më poshtë:

- a. Reduktimin e pragut për pagesat me para në dorë ndërmjet bizneseve nga 150 000 lekë që është aktualisht në 100 000 lekë.
- b. Vendosjen e një kufiri prej 500 000 lekësh për transaksionet me para në dorë midis individëve dhe të vetëpunësuarve/tregtarëve. Aktualisht, ligji nuk parashikon një kufi të tillë. Vendoja e kufirit prej 500 000 lekësh është bërë bazuar në transaksionet ekzistuese dhe mbështetur edhe në eksperiencat e vendeve të tjera.

Të dhënat nga administrata tatimore tregojnë metodat kryesore të pagesës së faturave nga bizneset, ku përfshihen banknotat dhe monedhat, kartat

bankare, çekët dhe voucher-ët, sipas kategorive të klientëve B2B (biznes me biznes) dhe B2C (biznes me konsumator), si dhe sipas intervaleve të shumave të faturës.

Pjesa dërmuese e qarkullimit vijon të dominohet nga cash-i, ndërkohë që përdorimi i mjeteve elektronike të pagesës është ende i kufizuar.

Kjo pasqyron një sfidë për rritjen e formalizimit dhe digjitalizimit. Nga të dhënat shihet se pagesat me para në dorë (cash) zënë një pjesë shumë të madhe të transaksioneve, si në numër faturash, ashtu edhe në totalin e vlerave të qarkulluara. Kjo tregon varësinë e lartë të tregut nga përdorimi i parasë fizike, sidomos në nivelet e faturave më të ulëta (deri në 50,000 lekë), ku është përqendruar pjesa më e madhe e transaksioneve.

Nga të dhënat e gjatëmujorit të parë të vitit 2025 rezulton se:

- rreth 46.4% e faturimeve mes biznesve dhe 9.7% e vlerës së transaksioneve mes bizneseve bëhet cash, në kushtet kur pragu është 150,000 lekë.
- rreth 90.6% e faturimeve mes biznesve me individët dhe 64.2% e vlerës së transaksioneve mes bizneseve dhe individëve bëhet cash.

- c. Detyrimin për pajisjen e tatimpaguesve me terminale “POS” në çdo pikë shitjeje, sipas afateve të përcaktuara në ligj, me përjashtim tatimpagueve të cilët ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat ku nuk ka mbulim interneti, për tatimpaguesit të cilët janë të përjashtuar nga lëshimi i faturës, si dhe për tatimpaguesit të cilët njëkohësisht janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, nuk janë subjekt i TVSH-së, nuk kanë mbi 1 vendodhje të ushtrimit të veprimtarisë dhe janë të vetëpunësuar të vetëm.

Pajisja me терминалет POS, për strukturat akomoduese, sektorin e transportit dhe institucionet publike dhe shoqëritë publike propozohet brenda datës 30 maj 2026, ndërsa për tatimpaguesit e tjerë brenda datës 31 dhjetor 2026. Këto afate synojnë që tatimpaguesit të kenë kohën e nevojshme në dispozicion për të përmbushur këtë detyrim ligjor dhe për ta lehtësuar sa më shumë procesin e pajisjeve me terminale POS. Ky ndryshim synon lehtësimin e kryerjes së pagesave elektronike, rritjen e transparencës dhe formalizimin e qarkullimit monetar përmes kanaleve bankare.

Gjithashtu, përsa më lart propozohet, me qëllim dhe uljen e kostove të implementimit të këtyre politikave, si për bizneset dhe tatimpaguesit, sqarojmë

se bazuar në informacionet nga Banka e Shqipërisë janë ndërmarrë dhe po vijnë të ndërmerren një sërë masash në kuadër të uljes së kostove të transaksione bankare, si dhe tarifave për pajisjen me terminalin POS. Ndër këto lehtësi mund të përmendim: ofrimin e terminalit POS falas për 12 muaj nga MasterCard, duke filluar nga 1 maj 2025, apo nxitjen për hyrjen në fuqi të rregullores së BE “Interchange Fee Regulation” e cila vendos një tavan kufizues për tarifat e bankave.

Këto masa synojnë përdorimin e mjeteve elektronike, rritjen e gjurmueshmërisë, formalizimin e ekonomisë private dhe reduktimin e evazionit fiskal.

5. Dhënia e të drejtës së tatimpaguesve individ për korrigjimin e deklaratës vjetore brenda 6 muajve dhe përmirësimi i vetëdeklarimit si dhe ndryshimi i afatit të dorëzimit të deklaratës së ndryshuar tatimore nga 36 muaj në 24 muaj

Në nenin 67, propozohet të shtohet një pikë 5, me këtë përmbajtje: “*5. Deklaruesi i Deklaratës Vjetore të të Ardhurave Personale mund të korrigjojë, deklaratën e dorëzuar, brenda 6 muajve nga data e dorëzimit por jo më shumë se dy herë.*”

Kjo shtesë vendos një rregull të veçantë për korrigjimin e deklaratës vjetore të të ardhurave personale nga individët, duke kufizuar afatin në 6 muaj nga data e dorëzimit dhe duke lejuar jo më shumë se dy korrigjime. Ky afat ka ekzistuar më parë në ligjin e shfuqizuar për tatimin mbi të ardhurat (3 muaj), por nuk është parashikuar në ligjin e ri, ndërkohë propozimi për një afat 6 mujor bëhet për lehtësi për tatimpaguesin, duke i mundësuar korrigjimin e gabimeve materiale brenda një periudhe më të gjatë kohore.

Gjithashtu, krijon një kornizë të qartë që parandalon abuzimet, duke siguruar balancë midis lehtësisë për individin dhe kontrollit administrativ nga tatimet. Për më tepër, individëve u krijohet mundësia për korrigjime të deklaratave të të ardhurave personale brenda 6 muajve dhe jo më shumë se dy herë.

Ndërkohë, reduktimi i afatit për dorëzimin e deklaratave të ndryshuara nga 36 muaj në 24 muaj synon të përmirësojë efikasitetin administrativ, duke patur një cikël më të shkurtër verifikimi. Nga të dhënat rezulton se mbi 94% e rasteve të dorëzimit të deklaratave të ndryshuara ndodhin brenda afatit 24 muaj, dhe pjesa tjetër përtej këtij afati.

Ky ndryshim pritet të rrisë korrektësinë e deklarimeve, të ulë gabimet e pavullnetshme dhe të kontribuojë në krijimin e një marrëdhënieje më transparente dhe bashkëpunuese ndërmjet tatimpaguesve dhe administratës tatimore.

6. Përmirësimi i procedurave për njoftimin e vlerësimeve tatimore dhe TVSH-së

Njoftimet e vlerësimeve tatimore dhe deklaratat e TVSH-së do të dorëzohen kryesisht elektronikisht, ndërsa në rast pamundësie përdoret shërbimi postar. Ndryshimet e bëra në nenin 23 janë bërë edhe në nenin 69 lidhur me njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesë. Kjo rrit transparencën dhe efikasitetin në njoftim, duke garantuar marrjen e akteve në kohë reale nga tatimpaguesi.

Sistemi elektronik plotëson automatikisht deklaratat e TVSH-së brenda 24 orëve pas përfundimit të afatit. Një ndër masat e parashikuara në Planin e Rritjes së BE-së për Shqipërinë është plotësimi paraprak i deklaratave të TVSH-së duke përdorur informacionin nga fiskalizimi brenda Dhjetor 2026. Administrata tatimore e realizoi parambushjen e deklaratës së TVSH që në muajin prill 2025. Për këtë arsye, propozimi ka parashikuar që në rast se tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e TVSH-së brenda afatit të përcaktuar në ligj, sistemi elektronik i administratës tatimore, brenda 24 orëve nga përfundimi i këtij afati, plotëson dhe dorëzon automatikisht deklaratën e TVSH-së mbi bazën e të dhënave të librit të shitjes dhe të librit të blerjes. Përgjegjësia për çdo penalitet për mosdorëzimin e saj në afat, i ngarkohet tatimpaguesit, i cili ka të drejtën ta kontrollojë, ndryshojë apo korrigjojë deklaratën, sipas procedurës dhe afateve të këtij ligji.

Propozimi rrit nivelin e përputhshmërisë tatimore, shmang mosdorëzimin e deklaratave dhe lehtëson detyrimet procedurale të tatimpaguesit.

7. Pezullimi i rimbursimeve gjatë hetimeve penale

Kërkesat për rimbursim të TVSH-së pezullohen kur tatimpaguesi është subjekt i hetimeve për veprat penale të mashtrimit ose fshehjes së të ardhurave. Përfshirja e elementeve penale si elemente risku në Rregullat e Rimbursimit të TVSH-së, të miratuara, është bërë nga administrata tatimore në vitin 2021, duke i përfshirë këto elemente në Rregulloren e miratuar të TVSH-së, për arsyen se:

- Nëse një tatimpagues po verifikohet apo hetohet për krijimin e skemave mashtruese të TVSH-së parimisht nuk mund të jetë subjekt i rimbursimit të tatimit të paguar tepër i pretenduar nëpërmjet mashtrimit.
- Parimi i përgjithshëm i së drejtës është që një procedim penal prevalon dhe “mban në vend” proceset e tjera civile apo administrative të lidhura ngushtësisht me të njëjtin rast.

Rregullorja për rimbursimin e TVSH-së për tatimpaguesit përfshin pezullimin e kërkesave për Rimbursim të TVSH-së në rast hetimesh për veprat penale të mashtrimit me TVSH ose fshehjes së të ardhurave.

Auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit kanë rekomanduar që ky mekanizëm të normohet ligjërisht, për të siguruar bazë ligjore të qartë, rritje të sigorisë juridike dhe harmonizim me procedurat e kontrollit të riskut.

8. Procedurat që do të zbatohen për shitjen e pasurisë së konfiskuar

Rritet efektiviteti i dispozitës ligjore, duke mundësuar nxjerrjen e një akti nënligjor që qartëson procedurat që duhet të ndjekë administrata tatimore për shitjen e pasurisë së konfiskuar, në zbatim të aktit administrativ të konfiskimit.

Procedurat që do të zbatohen për shitjen e pasurisë së konfiskuar, në zbatim të aktit administrativ të konfiskimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), e cila luan rol thelbësor në procesin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, tashmë ndodhet në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit dhe jo të ministrit përkatës. Për këtë arsye, referenca aktuale në dispozitën ligjore është e papërditësuar dhe nuk siguron funksionalitet të plotë në zbatimin e procedurave.

9. Përmirësimi i strukturave dhe kompetencave të Hetimit Tatimor

Njësitë e Hetimit Tatimor mund të kryejnë vlerësim tatimor paraprak në rastet e fshehjes së të ardhurave me qëllim mashtrimi, pas autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Ky propozim vjen me qëllim që strukturat e Hetimit Tatimor në cilësinë e strukturës funksionale dhe kompetente të administratës tatimore të mund të

kryejnë vetë një vlerësim tatimor paraprak për të gjitha rastet e konstatuara të konsumimit të veprës penale të fshehjes së të ardhurave kur vlera e tatimit, taksës apo kontributit të fshehur nuk është përlllogaritur paraprakisht nga strukturat e kontrollit tatimor.

Kryerja menjëherë e vlerësimit tatimor në këto raste, pa pritur procedurat normale ligjore të kontrollit tatimor minimizon problematikat lidhur me tejkalimin e afateve proceduriale, nxjerrjen e sekretit hetimor, prishjen e provave materiale etj.

10. Përfshirja e kamatëvonesave për institucionet publike

Kur mosrespektimi i afateve vjen si rezultat i zbatimit të aktit ligjor/nënligjor apo vendimeve gjyqësore me efekte prapavepruese.

11. Vendosja e sanksioneve administrative ndaj prodhuesve ose mirëmbajtësve të softëare-it të pajisjeve fiskale në rastet e refuzimit të bashkëpunimit me administratën tatimore

Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, administrata tatimore është përballur me raste të shumta refuzimi nga ana e prodhuesve dhe/ose mirëmbajtësve të softëare-it të fiskalizimit, lidhur me kërkesat për hapjen, verifikimin ose kontrollin e pajisjeve fiskale të konfiskuara. Kjo mungesë bashkëpunimi ka penguar ndjeshëm procesin e monitorimit dhe verifikimit të subjekteve tatimpaguese, duke kufizuar aftësinë e administratës për të garantuar funksionimin e rregullt të sistemit të fiskalizimit dhe për të parandaluar abuzimet me të dhënat fiskale.

Për këtë arsye, me anë të këtij propozimi parashikohet vendosja e sanksioneve administrative ndaj prodhuesve dhe mirëmbajtësve të softëare-it të pajisjeve fiskale, në rastet kur ata refuzojnë të bashkëpunojnë me administratën tatimore në përmbushjen e detyrimeve ligjore. Ky ndryshim synon të sigurojë bashkëpunim efektiv dhe transparencë ndërmjet administratës tatimore dhe subjekteve që operojnë në fushën e fiskalizimit, duke garantuar integritetin e sistemit dhe funksionimin e tij të pandërprerë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE).

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 19 nene, të cilat parashikojnë si vijon:

Neni 1 përcakton se në mënyrën e komunikimit me tatimpaguesin, aktet administrative mund të dërgohen elektronikisht ose përmes postës, duke siguruar pëlqimin e tatimpaguesit dhe detyrimin për deklarimin e adresës elektronike.

Neni 2 parashikon se veprimtaria ekonomiko-tregtare përfshin edhe aktivitetet e ushtruara nëpërmjet internetit dhe tatimpaguesit mund ta ushtrojnë aktivitetin vetëm pas regjistrimit si subjekte. Gjithashtu liston të dhënat që personat fizikë, individ tregtarë dhe të vetëpunësuar, dhe entitetet që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare sipas kësaj pike, duhet të publikojnë në faqen e internetit, përfshirë: numrin e NIPT-it, emrin e subjektit tregtar, adresën e selisë dhe numrin e telefonit, dhe si do të veprohet në rastet kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët nuk kanë të afishuar në faqen e tyre elektronike këto të dhëna.

Neni 3 përcakton se masat administrative ndaj subjekteve të paregjistruara përfshijnë të gjitha masat që ligji parashikon për shkeljet e konstatuara nga administrata tatimore, duke përfshirë rivlerësimin e TVSH-së për mallrat pa faturë.

Neni 4 parashikon shfuqizimin e pikës 7 në nenin për kalimin në regjistrin pasiv, duke thjeshtuar procedurën administrative. Kjo pikë parashikonte detyrimin e administratës tatimore për të publikuar listen e subjekteve joaktive dhe penalizimin e transaksioneve midis tatimpaguesve aktivë me ata me status të ndryshëm nga aktiv. Me zbatimin e projektit të fiskalizimit tashmë ky proces kryhet automatikisht dhe sistemi nuk lejon më transaksione midis tatimpaguesve aktivë me ata me status ndryshe nga aktiv.

Neni 5 përcakton se transaksionet me para në dorë ndërmjet bizneseve nuk duhet të jenë më shumë se 100,000 lekë, dhe ndërmjet individëve dhe subjekteve ekonomike nuk duhet të jenë më shumë se 500,000 lekë.

Neni 6 parashikon pajisjen me terminale POS të tatimpaguevse që përdorin para në dorë gjatë kryerjes së transaksioneve, afatet kohore në varësi të sektorit për pajisjen me këto terminale POS, si dhe përjashtimin nga ky detyrim për disa kategori tatimpaguesish.

Neni 7 parashikon se tatimpaguesi dorëzon deklaratën tatimore në mënyrë elektronike nga llogaria e tij në sistemin elektronik të administratës tatimore. Ky ndryshim propozohet pasi dispozitat ekzistuese të nenit 65, pika 1, parashikojnë edhe forma alternative dorëzimi të deklaratës tatimore, si nëpërmjet shërbimit postar apo bankës apo një institucioni tjetër financiar, të cilat nuk kanë gjetur zbatim praktik në ushtrimin e kompetencave të administratës tatimore.

Neni 8 përcakton reduktimin e periudhës së dorëzimit të deklaratës së re tatimore të ndryshuar nga 36 muaj në 24 muaj, si dhe u jep mundësinë individëve për korrigjim të deklaratës personale brenda 6 muajve dhe jo më shumë se dy herë.

Neni 9 parashikon procedurat për njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesë, duke specifikuar mënyrën e dorëzimit (elektronikisht ose postë) dhe përmbajtjen minimale të njoftimit.

Neni 10 parashikon që tatimpaguesi hyn në transaksione shitblerjeje me para në dorë që tejkalojnë shumën prej 100 000 lekë, duke u ndryshuar kështu nga vlera e mëparshme prej 150 000 lekë.

Neni 11 përcakton se sistemi elektronik i administratës plotëson automatikisht deklaratën e TVSH-së kur tatimpaguesi nuk e dorëzon në afat, duke e lënë përgjegjësinë dhe të drejtën për kontroll të deklaratës tek tatimpaguesi.

Neni 12 parashikon pezullimin e kërkesave për rimbursim TVSH për tatimpaguesit që janë subjekt hetimi për skema mashtruese.

Neni 13 përcakton se njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore përjashtohen nga kamatëvonesat kur mosdeklarimi vjen si pasojë e një akti ligjor, nënligjor ose vendimi gjyqësor.

Neni 14 parashikon se procedurat për shitjen e pasurisë së konfiskuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit të Financave.

Neni 15 përcakton se verifikimi dhe vlerësimi tatimor për rastet e fshehjes së të ardhurave kryhet nga Hetimi Tatimor pas autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 16 parashikon ndryshimin e referencave ligjore që i referohen ligjit të vjetër nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i cili është shfuqizuar, me referencat përkatëse të ligjit të ri nr. 29, datë 30.03.2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, që është aktualisht në fuqi.

Neni 17 përcakton ndryshimin e referencës ligjore për evazionin tatimor për harmonizim me dispozitat aktuale.

Neni 18 parashikon vendosjen e sanksioneve administrative ndaj prodhuesit dhe mirëmbajtësit të softëare-it të pajisjeve fiskale në rastet e refuzimit të bashkëpunimit me administratën tatimore.

Neni 19 përcakton se ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Financave ka draftuar projektligjin. Ky projektligj i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Bankës së Shqipërisë.

Paraprakisht, përpara se të dërgohet për mendim, ky projektligj është analizuar nga sistemi Copilot (asistenti zyrtar i Inteligjencës Artificiale të Microsoft) nga

këndvështrimi i teknikës legjislative. Nga ky vlerësim paraprak, rezulton se akti është shkruar në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, në përputhje me kërkesat e teknikës legjislative.

Agjencisa Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka shprehur komente mbi projektligjin, konkretisht sugjerojnë që togfjalëshi “...ose nëpërmjet shërbimit postar kur dorëzimi elektronik është i pamundur.” të hiqet duke qenë se, ky parashikim nuk është në përputhje me ndryshimet e miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 211, datë 9.04.2025 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Ky sugjerim është reflektuar në projektligj.

Ministria e Drejtësisë është shprehur parimisht dakord me projektligjin, por ka bërë disa sugjerime mbi të cilat shprehem, si më poshtë vijon:

- Për sugjerimin e parë që lidhet me pikën 3, të nenit 1, të projektligjit, dhe që rekomandon riformulimin e saj dhe rishikimin e terminologjisë së përdorur, shprehem se ky sugjerim është reflektuar në projektligj dhe pika 3, e nenit 1 është riformuluar.
- Në lidhje me sugjerimin e dytë për pikën 1/1, të nenit 2, të projektligjit, ku sugjerohet rishikimi i togfjalëshit “veprimtarinë e ushtruar nëpërmjet internetit”, dhe përcaktimin e llojit konkret të veprimtarive ekonomiko-tregtare të ushtruara, shprehem se përdorimi i këtij togfjalëshi është në përputhje me Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike Rev2, seksioni G, Kodi 4191, e cila përmban tregtinë me pakicë me mail ose nëpërmjet internetit. Pra, përdorimi i këtij togfjalëshi në projektligj është në përputhje me Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike.
- Sa i përket përcaktimit të llojit konkret të veprimtarive ekonomiko-tregtare, sqarojmë se neni përfshin të gjitha veprimtaritë tregtare të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, dhe nuk është e mundur të listohen të gjitha veprimtaritë në këtë nen pa kufizuar fushën e veprimtarisë.
- Për sugjerimin e tretë lidhur me nenin 11, për shmangien e përdorimit të lidhëzës së përbërë “dhe/ose”, në zbatim të rregullave të teknikës legjislative,

shprehemi se ky sugjerim është reflektuar në projektligj dhe neni 11 është riformuluar.

- Sugjerimi i katërt përsa i përket riformulimit në mënyrë sa më të qartë dhe ezaauruese të nenit 12, shprehemi se ky sugjerim është reflektuar në projektligj dhe neni 12 është riformuluar në përputhje me kërkesat e qartësisë dhe kuptueshmërisë.
- Lidhur me sugjerimin e pestë për rishikimin e nenit 13 , në raport me parashikimet e ligjit nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, vlerësojmë miratimin e procedurave me VKM në zbatim të kësaj dispozite.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTRI

PETRIT MALAJ